

në terren në Kosovë si pjesëtar i NJPP-së. Kohë pas kohe, kthehej për disa ditë për ta vizituar familjen. Herën e fundit ka qenë në shtëpi më 5.09.1998. Në datën **13.09.1998**, Gorani me një grup policësh po kalonin me kamion nëpërmes **Makërmalit/Makrmalj**, kur ushtarët e UÇK-së hapën zjarr. Goranin e kanë plagosur rëndë në shpinë. Së pari, e transferuan në spitalin e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, pastaj në Prishtinë/Priština, ndërkaq ditën tjetër në AMU në Beograd. Ka dhënë shpirt më 25.09.1998. E kanë varrosur në varrezat e qytetit të Vladiçin Hanit.

Burimet: deklarata B.N, FDH-24973; SMIP, *Teroristički...*, III, 489; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 48.

Arif (Mehmet) Desku

(25.10.1932, shqiptar nga Siqeva/Siqëvo, komuna e Klinës/Klina, bujk, dy fëmijë)

Arifi i moshuar jetonte te djali i axhës Dauti dhe familja e tij. Arifi vuante nga problemet në të folu. Në datën 12.09.1998, ai me familjarët e vet e braktisën fshatin dhe, së pari, u strehuan në fshatin **Ticë/Tica**. Në datën **15.09.1998**, Arifi vendosi të shkonte te motra në fshatin Pllaqicë/Ploçica [Malishevë/Mališevo]. U nis vetëm dhe nga ky çast askush nuk e kishte parë më. Familja ka bërë përpjekje të pasuksesshme për ndriçimin e fatit të tij. Motra Ajshe pati dhënë mostrën e gjakut për analizën e ADN-së. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Arifit është evidentuar me numër BLG-803985-01.

Burimet: deklarata D.D, FDH-15418; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Bajram (Abaz) Makolli

(1931, shqiptar nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dy fëmijë)

Nga vdekja e bashkëshortes dhe martesë e dy vajzave, Bajrami jetonte vetëm në shtëpinë e vet në Polac/Poljance, jo shumë larg nga rruga kryesore Skënderaj/Srbica – Glogoc/Glogovac. Vuante nga problemet psikike. Në datën **18.09.1998**, të gjithë nga mëhalla e tij e kanë braktisur fshatin. Mوندoheshin ta bindnin Bajramin

që të nisej me ta, por ai refuzoi ta braktiste shtëpinë [**Polac/Poljance**]. Ishte kjo hera e fundit kur e shihnin të gjallë. Pas lufte, farefisi i Bajramit dhe banorë të tjerë u kthyen në Polac/Poljance. I gjetën shtëpitë të shkrumbuara nga zjarri, por nuk kishte asnjë gjurmë të Bajramit. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Bajramit është sistemuar në lëndën me numër BLG-803826-01.

Burimet: deklarata M.M, FDH-19878; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Hateme (Rexhep Peci) Meha

(1924, shqiptare nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, dy fëmijë, civil)

Hateme e moshuar jetonte në bashkësi familjare me bashkëshortin Lahun dhe djalin e Lahut me familje. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin [Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze] më **22.09.1998**, Abiti me familje, së bashku me banorë të tjerë, u strehuan në pyll. Lahu me Hetemen kanë mbetur vetëm në shtëpi. Përderisa qëndronin në oborr, ata e vërejtën një grup ushtarësh serb t'i afroreshin shtëpisë së tyre. Hapën zjarr drejt shtëpisë. Lahu u strehua pas ahurit, ndërkaq ajo mbeti në oborr [**Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze**]. Kur pjesëtarët të forcave serbe e vranë qenin e tyre, ajo hyni në shtëpi. Disa ushtarë hyrën pas saj. Kur dolën dhe u larguan pas disa minutash, shtëpinë e kaploi zjarri. Lahu hyri menjëherë në shtëpi dhe në korridor e gjeti trupin e pajetë të Hatemes. E kishin vranë me tre plumba në gjoks. Lahu e fiku zjarrit. Një ditë më vonë, Lahu me ndihmën e vëllezërve të vet e kanë varrosur Hetemen në varrezat e Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze.

Burimet: deklarata A.M, FDH-18174; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Hamit (Kajtas) Kadriu

(16.10.1924, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, pensionist, pesë fëmijë)

Hamiti para pensionimit punonte në